

Vendim

Nr.90, datë 27.1.2009

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES HIDROKARBURE, PËR ZHVILLIMIN DHE PRODHIMIN E HIDROKARBUREVE NË VENDBURIMIN E VISOKËS, NDËRMJET ALBPETROL, SHA-SË DHE IEC VISOKA, INC

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 12 e 13 të ligjit nr.7746, datë 28.7.1993 “Për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi)”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e marrëveshjes hidrokarbure, për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve, në vendburimin e Visokës, ndërmjet Albpetrol, sh.a. dhe IEC Visoka, Inc, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha